



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI I LËNDËS

TEKNIKË & LAB. I GJUHËS SË SHKRUAR

**Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Elda KATORRI**

**Ngarkesa:** 4 kredite; 40 orë mësimore; 40 seminare

**Tipologjia e lëndës:** B

**Viti akademik:** Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I / Semestri I

**Lloji i lëndës:** Lëndë me zgjedhje

**Programi i studimit:** “Bachelor” - *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:** [elda.katorri@unitir.edu.al](mailto:elda.katorri@unitir.edu.al)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

*Objektivat e përgjithshme lëndore:* Ky kurs synon t’u japë mundësi studentëve të zhvillojnë kompetencën komunikative në të shkruar, duke u kujdesur për drejtshkrimin, gramatikën, shtrirjen tekstuale, kohezionin dhe koherencën, duke përmirësuar aftësinë e të shkruarit të teksteve të llojeve të ndryshme me vështirësi në rritje si tekste informative, tekste përshkruese, tekste tregimtare, tekste argumentuese. Shkallët e kompetencës së lakmueshme për t’u arritur në fund të kursit ndryshojnë në varësi të nivelit të nisjes por gjithmonë në përputhje me KPERGJ (Kuatri i Përbashkët Evropian i Referimit për Gjuhët).

*Objektivat specifike lëndore:* Ky kurs synon t’i aftësojë studentët që të shkruajnë një tekst të thjeshtë të natyrës informative, përshkruese, regulluese; të rrëfejë me shkrim një ngjarje në të cilën ka marrë pjesë duke shprehur vlerësime në mënyrë të thjeshtë dhe koherente, ndjenja, opinione personale; të shkruajë tekste të shkurtra dhe të përmbledhura sipas kontekstit për të treguar momente të jetës së përditshme, familiare, shkollore; të shkruajë e-mail-e të thjeshta, fax-e, letra informale për të kërkuar apo për të dhënë informacione e shpjegime të sakta lidhur me tema të njohura; të përmbledhë qartë me shkrim një tekst të lehtësuar ose të thjeshtësuar të natyrave të ndryshme (letrare, historike); të nxjerrë në dukje vijimësinë logjike dhe kohore me anën e pyetjeve;